



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

WWRO/STO/WD -11/2006

16 Maj 2006

Nr:241/D

URDHËRESË E TARIFAVE TË SHËRBIMIT

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E DEPONIMIT TË MBETURINAVE QË DUHET TË APLIKOHEN NGA KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A.

Në përputhje me autoritetin e dhënë me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49 *Mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit, Ujërave të Zeza dhe Mbeturinave* të dates 26 nëntor 2004 ("Rregullorja")

Duke marrë parasysh rezultatet e shqyrtimit të aplikacionit për Tarifa të Shërbimit të dorëzuar nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A.

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) me këtë nxjerrë si vijon:

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat dhe shprehjet e shkruara me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që atyre iu është atribuuarnë Rregullore si dhe në *Rregullën për Licencimin e Operatorëve të Deponive në Kosovë* (R 01/SWD) të lëshuar më 26 Janar 2005.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A. që me këtë obligohet të procedojë me faturimin e konsumatorëve të vet për shërbimet e deponimit të mbeturinave në përputhje me këtë Urdhëresë Tarifore.

3. Lista e Tarifave të Shërbimit

Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë Sh.A. për shërbimet e deponimit të mbeturinave do të aplikojë tarifën në lartësi prej: **8.60 EUR për ton** të mbeturinave të deponuara.

4. Kohëzgjatja

Tarifat e Shërbimit të aprovuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit do të hyjnë në fuqi nga data **1 Qershor 2006** dhe do të jenë efektive dhe në fuqi të plotë deri më datën **31 Maj 2007**.

5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së tarifave të Shërbimit

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh. A. do të njoftojë të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza që furnizohen me Ujë me Shumicë me Tarifat e aprovuara me këtë Urdhëresë të Tarifave në momentin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime si dhe së paku një herë në vit bashkangjitur me Faturë.

6. Apelet


Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh. A. ka të drejtë të apelojë tek Komisioni për Shqyrtim që themelohet konform Rregullores së ZRRUM-it.

7. Gjuha Zyrtare e Urdhëresës së Tarifave

Kjo Urdhëresë e Tarifave nxjerret dhe publikohet në tri (3) versione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë:

- 1) Shqip,
- 2) Serbisht, dhe
- 3) Anglisht.

Në rast të mospërputhjeve në mes të versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën Angleze.


Afrim Lajçi
Drejtor i ZRRUM